



KOMUNA E TEARCËS

Në bazë të nenit 18 paragrafi 2 nga Ligji për nëpunës shtetëro (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.59/00,112/00,34/01,103/01, 43/02, 17/03,85/03,17/04,69/04,82/05, 61/06,36/07, 114/09, 35/10, 167/10,36/11, 6/12, 2412,15/13,82/13,106/130) dhe në përputhje me aktet nënligjore të kodit të etikës për nëpunës shtetëror (“ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.129/11), Kryetari I komunës së Tearcës përgaditi:

KODI ETIK PËR POLITIK TË ANTIKORUPSIONIT – POLITIKËN E INTEGRITETIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

- Komuna e Tearcës nuk toleron sjellje koruptive respektivisht shfrytëzimi i funksionit, autorizim publik, veprimtari dhe qëndrim zytarë, për realizimin e ndonji interesi të punësuarit ose tjetër. Poashtu, komuna e Tearcës nuk toleron çfardo forme tjetër të sjelljes joetike dhe jomorale e cila është e ndaluar ligjërisht dhe në kundërshtim me normat etike të sjelljes.
- Kryetari dhe strukturat udhëheqëse të komunës së Tearcës janë përgjegjës për vërtetimin dhe mënjanimin e rezikut për korupsion, përvetësim, vjedhje, ryshfet, konfliktit të interesit, përdorimi i ndikimeve në mënyrë që të merret trajtim preferencial ose çfardo forme të tjetër të sjelljes joligjore dhe joetike.
- Punonjësit e Komunës së Tearcës nënshkruajnë një deklaratë që do t'i detyrojë ata që të respektojnë politikën e integritetit të komunës.
- Punonjësit e Komunës së Tearcës janë të obliguar të sillen me vetëdije, në mënyrë profesionale dhe me përgjegjësi ti respektojnë procedurat e përshkruara dhe afatet për trajtim, të jenë lojal për organizatën e tyre, të largohen nga konflikti i interesit dhe të kujdesen për reputacionin e saj publik, pa dallim gjenden ose nuk janë në vendin e punës, dhe në çdo kohë.
- Punonjësit janë të detyruar të raportojnë çdo sjellje të dyshuar për korrupsion dhe / ose sjellje të tjera të palejuar, të paligjshme dhe joetike, në mënyrë të përshkruar me procedurat për lajmërim dhe trajtim me aplikacionet e paraqitura.
- Punësuarit të cilëve u është ofruar ryshfet ose janë të inicuar për veprim joligjor ose joetik, duhet ta ndalosh procesin e komunikimit me personin dhe për të ta lëajmorojnë personin e autorizuar për lajmërim të korupsionit në komunë duke i sqaruar detajet e kogës, vendit, bashkëbiseduesit dhe lëndën e bisedimit.

- Në qoftë se punonjësi nuk vepron sipas procedurës së përshkruar, kundër tij do të ngrihet një procedurë adekuate.
- Paraqitja e sjelljes korruptive, jo e lejuar, jo ligjore dhe jo etike të personave kundër të punësuarit në komunë është obligim i secilit punonjës. Ajo nuk është problem personal, as e drejtë për zgjedhje, por është pjesë e detyrës dhe përgjegjësisë zyrtare.
- Punonjësit të cilët kanë qenë dëshmitar ose kanë dyshime të bazuara për sjellje joetike ose joligjore të punësuarve në komunë detyrimisht duhen në formë të shkruar, në mënyrë telefonike ose nëpërmjet postës elektronike të informojnë personin zyrtarë për paraqitje të korrupsionit në komunë.
- Punonjësit i cili paraqet sjellje korruptive, jo të lejuar, jo ligjore dhe joetike i garantohet besueshmëria(konfidencialiteti).
Paraqitësi ka të drejtë për mbrojtje nga pasojat e paraqitjes.
- Punonjësi i cili do të veprojë në mënyrë që të përdorë pozitën dhe pozicionin e tij zyrtar do të ndiqet penalisht në përputhje me Kodin Penal.
- Sjellja e punonjësit në kundërshtim me kodin etik tëheqë përgjegjësi disiplinore.
- Diçka që është e përfshirë në këtë politikë antikorruptive nuk e lejon punonjës në aspekt të paraqitjes deri te organet përkatëse , për çdo dyshim ose ekzistim të provave për punë joligjore në detyrë.
- Punonjësi i cili ka raportuar dyshime ose prova të mosveprimit ose kundër veprimeve ligjore, në baza realiste dhe të arsyeshme, si dhe me qëllime të sinqerta, nuk mund të mbajë përgjegjësi për realizimin e aplikacionit.
- Për raportim me qëllim të keqë ose të rremë ose dhënien e një deklaratë të rreme, do të merren masa ligjore të përcaktuara ligjërisht.
- Në komunën e Tearcës do të formohet Komision për marjen e aktiviteteve për zbatimin, ndjekjen dhe koordinim të sistemit të themeluar për integritet (grupi punues për integritet).
- Pas pranimit të paraqitjes për mito, korrupsion dhe konfliktit të inetresit, grupi punues për integritet, në bazë të principit të besueshmërisë, do ti grumbullon të gjitha informacionet e duhura për rastit konkret dhe do të dërgon një raport deri te Komisioni shtetëror për ndalimin e korrupsionit në formë të shkruar ose nëpërmjet formës elektronike.
- Grupi punues për integritet rregullisht do mban mbledhje me udhëheqësit dhe do të realizon trajnime me qëllim të sqarimit të dëmeve nga sjellaj korruptive. Poashtu do punon për ngritjen e vetëdijes të punënjësve për sistemin e integritetit të komunës dhe respektimi i qëndrueshëm. Në këtë mënyrë komuna e Tearcës në mënyrë preventive do ta lufton korrupsionin.